



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
MINISTRI

№. 6604 Prot

Tiranë, më 19.12.2011

UDHËZIM

Nr. 45, datë 19.12.2011

PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 58, pika 3 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Çdo student në momentin e pranimit duhet të regjistrohet në regjistrin bazë të studentëve. Çdo student, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë (IAL), jepet një numër unik matrikulimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës.
2. Studentët e marrin numrin e matrikulimit (NIM) të përbërë nga gjashtë gërma dhe dy shifra të kodit të regjistrimit dhe katër shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikulimit është sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Në rast se një student largohet ose transferohet nga një fakultet pa e përfunduar kursin e studimit, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.
4. Regjistrat e studentëve për vit akademik, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të organizohen në bazë njësie kryesore (fakulteti), cikli studimi dhe formë studimi.
5. Cdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga gjashtë gërma dhe dy shifra. Gërma e gjashtë e kodit të regjistrimit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit sipas shtojcës nr.2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Kodet e regjistrave në përdorim për çdo Institucion të Arsimit të Lartë, përcaktohen nga Agjencia Kombëtare të Provimeve (AKP).
7. Për hapjen e një regjistri IAL, duhet të aplikojë në AKP për të marrë kodin e regjistrit përkatës.
8. Brenda një fakulteti regjistrat bazë të studnetëve të organizohen më vete për cdo formë studimi (sistemi me kohë të plotë, kohë të pjesshme, edukim në distancë, etj.) dhe për secilin cikël studimi (cikli I, cikli II dhe cikli III).
9. Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 e në vazhdim, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), në format EXCEL, sipas shtojcës nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet. IAL-të të dërgojnë të dhënat në AKP, sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet.
10. AKP brenda 1 muaji i dërgon institucioneve të arsimit të lartë, listën përkatëse të numrave të matikulimit për çdo studentë.
11. AKP përgatit rregulloren teknike të administrimit dhe sigurisë së bazës shtetërore (Kombëtare) të të dhënave të studentëve.
12. Udhëzimi nr. 19, datë 18. 07. 2007 i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matikulimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.
13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

MYQEREM TAFAJ



MINISTËR



Shtojca nr. 1

a. Formimi i numrit të matrikulimit

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| U | T | F | S | N | A | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

Universiteti

Fakulteti Tip. Regj Programi Nr. i Amzës

Kodi i IAL përbëhet nga dy gërma të cilat vendosen në mënyrë unike.

Kodi i Fakultetit përbëhet nga pesë gërma ku dy të parat përbëjnë Kodin e IAL-së përkatëse.

Tipi i Regjistrimit do të varet nga cikli dhe forma e studimit. Ai do të jetë i njehsuar për të gjitha IAL-të: një cikël studimi + një formë studimi do të përdoret të njëjtën gërmë.

Programi i studimit përbëhet nga dy shifrat e para të cilat vendosen në mënyrë unike. Gjashtë gëmat dhe dy shifrat e para përbëjnë kodin e regjistrimit dhe përcaktohen nga AKP.

Shtojca nr. 2: Përcaktimi i numrit të llojit të regjistrit

| Gërma_Regjistri | Regjistri Tip, Përshkrimi |
|-----------------|--|
| A | Bachelor - KP (Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë) |
| B | Msc - KP (Cikli i dytë i studimeve, Master i shkencave/Master i arteve të bukura, me kohë të plotë) |
| C | Bachelor - PT (Cikli i parë i studimeve, me kohë të pjesshme) |
| D | Msc - PT (Cikli i dytë i studimeve, Master i shkencave/Master i arteve të bukura, me kohë të pjesshme) |
| E | Msc - KP (Cikël unik 5 vjeçar, me kohë të plotë) |
| F | Msc - PT (Cikël unik 5 vjeçar, me kohë të pjesshme) |
| G | MP - KP (Cikli i dytë i studimeve, Master Profesional, me kohë të plotë) |
| H | MP - PT (Cikli i dytë i studimeve, Master Profesional, me kohë të pjesshme) |
| K | SPM - KP (Specializim postMaster, me kohë të plotë) |
| L | SPM - PT (Specializim postMaster, me kohë të pjesshme) |
| M | SPECIALIZIM AFATGJATË |
| N | DOKTORATE |
| P | Bachelor - DIST (Cikli i parë i studimeve, në distancë) |
| Q | DP – KP (Program studimi Jo Universitar Profesional/ish SLU, me kohë të plotë) |
| R | DP – PT (Program studimi Jo Universitar Profesional/ish SLU, me kohë të pjesshme) |
| X | Regjistër i mbyllur |
| Y | Regjistër i mbyllur |
| Z | Regjistër i mbyllur |

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 2222260, Fax : +355 4 2232002

